



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:134950
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05762864

CP.nr.238/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, duke vendosur sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit të kreditorit, A.B., nga fshati Lubizhdë Komuna e Prizrenit, i paraqitur ndaj debitorit, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës në Prizren, për përmbarrimin e vendimit Inspektorati i Punës me Nr.643/2020 të datës 16.11.2020, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 2,180.16 euro, lidhur me kompensimin e pagave percjellëse, jashtë seancës dëgjimore, me datë 31.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.HIDHET POSHTË si i palejuar propozimi për përmbarrim i kreditorit, A.B., nga fshati Lubizhdë Komuna e Prizrenit, i paraqitur ndaj debitorit, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës në Prizren, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 2,180.16 euro, lidhur me kompensimin e pagave percjellëse.

II. Gjykata Themelore në Prizren, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore që të procedoj në këtë çështje përmbarrimore.

A r s y e t i m

Kreditori i përmbarrimit, A.B., nga fshati Lubizhdë Komuna e Prizrenit, te kjo gjykatë si organ përmbarrues, ka paraqitur propozim për përmbarrim, ndaj debitorit, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës në Prizren, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 2,180.16 euro, në emer të kompensimit të pagave percjellëse.

Departamenti i Përgjithshëm i kësaj gjykate, duke u kujdesur për kompetencën lëndore, dhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit me numër 08/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarrimore i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.05/L-118,

Numri i lëndës: 2024:134950
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05762864

vlerësoi se për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore, lidhur me propozimin e kreditorit, kompetentë është Organi i Përmbaruesit Privat të licencuar në Republikën e Kosovës.

Gjykata, pasi i analizoi shkresat e lëndës, gjeti se për të vendosur për këtë çështje përmbarimore, është Organi Përmbarues, Përmbaruesit Privat i licencuar në Republikën e Kosovës, kjo nga arsyet në vijim: Sipas Ligjit 08/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore të Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.05/L-118, me nenin 3 par 2 thuhet se, neni 5 i ligjit bazik pas paragrafit 6 shtohet paragrafi i ri 7 ku thuhet se, *Përmbaruesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe zbatimin e përmbarimit..... lidhur me kompensimet nga marrëdhënia e punës.*

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 3, 17 të LPP-së, e lidhur me nenin 19 dhe 392 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm
CP.nr.238/2024 datë 31.05.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mundet të paraqes ankesë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat brenda 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktvendimi.